

RAPORT PARAPRAK

I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER AKTIVITETIN VENDEPOZITIM I MBETJEVE URBANE

për qytetet Rrëshen dhe Rubik

(Sipas Ligjit nr.10 440 date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” shtojca 2 kodit 11.b)



Vendndodhja e ushtrimit te aktivitetit : Fshati Ndërfushaz, Bashkia Miredite, Qarku Lezhe

INVESTITOR : “AYEN AS ENERGJI” Shoqeri Aksionare

PROJEKTUES : « STUDIO PROJEKT » shpk

TIRANE 2017

PERMBAJTJA

Hyrje

- a. Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi
- b. Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij
- c. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer
- d. Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve
- e. Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara
- f. Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te
- g. Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin
- h. Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis
- i. Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)

HYRJE

Subjekti “AYEN AS ENERGJI” është shoqëri Aksionare, rregjistruar në QKR me NIPT L11731504A , për aktivitetin Veprimtari për zbatimin e kontratës Kocensionare me nr.5446 rep; nr.1944 kol, të datës 02.05.2011 miratuar me VKM Nr.365, datë 04.05.2011, dhe që ka hyrë në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare Nr.62, datë 23.05.2011. Financimi, projektimi, ndertimi, venien në punë, administrimin, mirembajtjen e hidrocentraleve Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit dhe Fangut, dhe transferimin e tyre në perfundim të kontratës nga Konkensionari tek Autoriteti Konktratuës, në zbatim të kësaj kontrate koncesioni, **me administrator Fahrettin Amir Arman** dhe seli qendrore ABA Business Center , kati 11, Rruga Papa Gjon Pali II, Njesia Bashkiake nr.2, Tiranë.

Raporti Papraprak i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis lidhet me aktivitetin e ndertimit të vendepozitimit të mbetjeve urbane për qytetet Rreshen dhe Rubik.

Ndertimi i këtij vendepozitimi është i domosdoshëm sepse vend-depozitimi ekzistues po mbyllet si rezultat i pozicionimit të tij në zonën e përmbajtjes nga ndertimi i HEC-it mbi lumin Fan.

Raporti synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor të projektit të propozuar efektet lidhur me ndikimet në floren, faunen, ujë , emetimin e gazeve të sere në atmosferë, shkarkimet në tokë, ujë, ndotjen akustike, si dhe cdo ndikim social ekonomik në punësimin lokal, përmirësimin e infrastrukurës dhe ndikimeve të tjera të rendesishme mjedisore ose sociale, përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësive dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nepermjet :

- Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit në fazën e përgatitjes së projektit.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Të japë një gjendje sa më reale, nga pikepamja e ndikimit të aktivitetit
- Analizën e faktoreve pozitive e negative mjedisore, përcaktimin e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Projekti tenton përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuesë të territorit, gjatë shfrytëzimit të tij.

Për këtë problem u bë mbikqyrja e terrenit në të gjithë zonën, duke kryer vërtetime të ndryshme , si dhe të biodiversitetit. Mjedisin dhe mbrojtja e tij nuk është i rendesishëm vetëm për njëzërit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Njëzërit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos demtohen por të jete e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet. VNM nuk do te mbuloj cdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjetër është te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

Gjate hartimit te ketij raporti eshte marr ne konsiderate edhe legjislacioni mjedisor ne Shqiperi. Ne Shqiperi fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen ne vitin 1993 , vit ne te cilin u hartua plani i pare i veprimit ne fushen mjedisore, qe perben dokumentin e pare zyrtar shqiptar mbi politikat mjedisore ne vend. Ky plan veprimi kombetar parashikonte se qeveria duhet te krijojte kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional per zgjidhjen e ceshtjeve mjedisore. Periudhen nga ky vit deri ne miratimin e Kushtetutes ne vitin 1998 mund ta konsiderojme si etapen e pare te zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit. Mbas vitit 1998 e ne vijim eshte periudha e dyte e zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e perafimit me legjislacionin e Bashkimit European per mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar eshte ne persosje dhe pasurim te vazhdueshem dhe zhvillimi i tij nuk i eshte len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislacionin european te mjedisit. Duke qen se kushtetutat ravijezojne drejtimet e rregullimeve te ardhshme dhe me te hollesishme qe realizohen fillimisht me ligje dhe me pas me akte nenligjore edhe ne rastin e vendit tone Kushtetuta perben nje fillese dhe baze te rendesishme lidhur me rolin qe ka mjedisi per shoqerine dhe shtetit tone. Nisur nga permbajtja e neneve te Kushtetutes lidhur me fushen mjedisore mund te pohojme se fryma e Kushtetutes sone eshte ne perputhje me ate te shume kushtetutave te vendeve te tjera demokratike qe u kushtojne rendesi te nje niveli me te larte disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato ne nivelin e ligjit themelor te shtetit, sic jane e drejta per informimin e qytetareve dhe angazhimi e pergjegjesia per nje mjedis te pershtatshem per te jetuar jo vetem brezat e sotem por edhe ata ne te ardhmen.

- VKM nr.686 date 29.7.2015 « *Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore* »
- Ligj nr 12/2015 *per disa ndryshime ne ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « Per vleresimin e ndikimit ne mjedis »*
- VKM nr. 435 date 12.09.2015 « *Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise* »
- VKM nr. 575 date 24.06.2015 “*Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte*”
- Udhezim nr. 1738 date 12.3.2015 *Mbi kriteret e studim projektimit per rehabilitimin e vendepozitimeve te mbetjeve te ngurta urbane, si dhe ndertimin e lendfilleve apo impianteve te trajtimit te mbetjeve te ngurta urbane.*

- VKM nr.419 date 25.6.2014 « *Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subject te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKLja.*
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “*Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore*”
- Vendim nr. 13 date 4.1.2013 « *Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- VKM nr. 765 date 07.11.2012 “*Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura*”
- Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “*Per Mbrojtjen e Mjedisit*”
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “*Per menaxhimin e integruar te mbetjeve*”

Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « *Per Lejet e Mjedisit* »

- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « *Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis* »
- Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 “*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*”.
- Ligj nr. 10266 date 15.04.2010 “*Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja*” per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 8897 dt. 16.05.2002 “*Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja*”
- Udhezimin nr.12 date 15.06.2010 per disa ndryshime ne Udhezim nr. 6527 date 24.12.2004 “*Mbi Vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menytrat e kontrollit te tyre*”
- Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”*Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes*”
- Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “*Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara*”
- Udhëzim Nr 3, datë 17.05.2006 “*Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret*”
- VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “*Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse*”.
- Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “*Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur*”. Të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “*Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta*”
- Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “*Për zonat e mbrojtura*”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « *Per largimin publik te mbeturinave* »

Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.

- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Perdorimin e aktivitetit ne menyre qe te respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones per rreth.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale negative te projektit te zbatuar
- Lehteson informimin e organeve vendim-marrese, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shendetit te njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peizazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permireson aspektet sociale te projektit.

a. Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi

Per nga origjina , perberja dhe veçorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenazonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket veçorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone. Por kushtet konkrete te zhvillimit, sidomos te klimes dhe te relievit kane percaktuar edhe veçorite origjinale te flores se Shqiperise. E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet veçorive te evolucionit paleogjeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore (karbonatike, magmatike, terrigjene) etj.

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet më me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendimmarrjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithë rruzullin tokesor. Ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejne bazat per ekzistenen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.

Rajoni eshte i pasur me bimesi , si ne lloje dhe ne shtrirje. Ai shpreh bashkeveprimin e ndersjellte e kompleks te perberjes litologjike, kushteve klimatike, edafike, ekologjike etj. Ketu

takohen vende me mikroklima te bute, ku rriten lirshem drure me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa, dellinja, frasher, shkoze, mret, gjineshtra, ferra, murrizi, dushku, shege e eger etj. Hapesirat me te medha te rajonit mbuloohen nga shkurret e tipit meshdhetar me gjelberim te perhershem e gjetherenes. Bimesia shkallezohet vertikalisht me breza te ndryshem.

Ndikimi i njeriut vitet e fundit ka rrene, ne kete zone nuk priten dru per perdorim nga banoret. Shkurret dhe druret jane pjese e rendesishme e mbuleses bimore, jo vetem per evoluimin e peizazhit por edhe per arsyen sepse ato jane percaktuese per mbrojtjen nga erozioni.

Siperfaqja e kerkuar per heqje nga fondi pyjor kullisor i Lugines se Fanit te Madh eshte =36 526 m²

Ura peshore e mbetjeve urbane S= 60 m²

Zyra, Administrata S=42 m²

Gropa septike S=15 m²

Trajtimi i ujerave te mbetjeve urbane S=1904 m²

Sheshi i depozitimit te mbetjeve urbane S=11123 m²

Rruge sherbimi S=2902 m²

Siperfaqe e gjelberuar me bar dhe peme te zones S=7000 m²

Aktualisht zona nuk ka ndonje perdorim te vecante, ajo perdoret nga banoret e zones per kullote.

Vendodhja e projektit te vendepozitimit ndodhet ne afersi te vendepozitimit egzistues rreth 3 km, ne afersi te rruges automobilistike Ura e Fanit-Shpal (aksi I vjeter fshati Nderfushaz). Eshte zone kodrinore e bute e veshur me bimesi kryesisht lis dhe shkurre mesdhetare. Pozicioni gjeografik eshte i favorshem per nje projekt te tille. Ka largesi te mjaftueshme nga autostrada Rreshen –Kukes si dhe nga qendrat e banuara ne afersi fshati Nderfushaz dhe Nderfushas.

Mareja (Arbutus unedo L.)

zakonisht shkurre te perherblera, gjethet te kembyera, me bishtak. Lulet 5- pjeseshe, ne melthe skajore me brakte. Nenpetlat te kunderngjitura ne baze. Kurora ne trajte qesje me vriguj te sperveshur, renese. Theke 10, me fije leshtore. Frutat e saj mblidhen nga komuniteti i zones per prodhimin e pijeve alkoolike.

Shqopa (erika arborea)

shkurreza ose shkurre perherblera. Gjethet qerthullore, vizake. Lulet 4- pjeseshe. Nenpetlat te lira, te gjelbra ose si ne ngjyre trendafil, me te shkurtra se kurora. Kurora cilindrike ose kabanore, me vruhuj me te shkurter ose te barabarte me gypin, e qendryseshme ne fryt.

Gjineshtra (Spartium junceum)

Shkurre ose shkurreza me gjemba ose pa gjemba. Gjethet te thjehsta ose me tri gjetheza. Lulet ne vile ose lemshuke sqetullore, rrale te vetmuara. Kupa dybuzore, buza e sipërme e care dysh, e

poshtmjia me tri dhembe. Kurora e verdhe. Nga komunitetë përdoret edhe për thurje shportash artistike.

Dellinje (juniperus)

Shkurre ose drure monoike ose dioike, gjethet të qëndrueshme, halore ose mëllogore, të perkunderta ose në qethuj nga tre. Lulesas mashkull skajore ose sqetulllore, vezake. Bocezat sqetulllore ose skajore, piquen vitin e parë, të dytin, ose të tretin, rruzulllore ose vezengjashme, mëllogat mishtake, të ngjitura ndërmjet tyre. Rritet në zone me pak lagështi, frutet e saj përdoren kryesisht në industrinë mjekësore dhe pijeve alkoolike.

Shkoze (carpinus)

Drure ose shkurre me lëkurë të lëmuar të perhime. Sythat majëprehte me mëlloga të hsumta. Gjethet në kohën e lulezimit në zhvillimin e sipër. Fryti me peshë të lehtë të vrigulluar ose të dhembëzuar. Gjethet e saj janë ushqim kryesor për blegtorinë.

Dushk (quercus)

Drure, rrallë shkurre. Druret me palcë yndyrore peskendeshe. Sythet vezengjashëm, gjethet të vrigulluara ose të dhembëzuara, rrallë të plota, rënë ose të perhereblerta. Cdo lule rrethohet nga një peshë të lehtë që drunjezohet dhe shoqëron lëndët. Dushku gjendet në disa forma si dushk, lis, qarr etj., ka përdorim gjethet e tyre, lëndët kryesisht ushqim për blegtorinë, gjithashtu përdoret edhe për ngrohje.

Murriz (crataegus)

Shkurre ose dru i vogël, zakonisht me gjemba e me gjethë rënë. Gjethet të thjeshta, të vrigulta ose pendore të cara, të sharruara. Ndajgjethëzat të qëndrueshme. Lulet në vastak. Petlat vezake të përmbysëta të bardha.

Frasheri (Fraxinus.)

drure gjethërenes, degezat të sheshta në një, gjethet të perkunderta, nganjëherë në qethuj nga 3, tekpendore. Lulet hermafrodite ose njëseksore, të vogla, në mëllthe skajore ose sqetulllore. Nga komuniteti i zonës gjethet dhe leverat përdoren për ngjyrosje të veshjeve, për të njëjtin qëllim përdoren dhe nga industria kimike.

Manafërre (rubus)

Gatishkurreza, shkurreza ose shkurre. Kercejt zakonisht me thumba. Gjethet pendore ose të gishtëzuara. Gjethëza dhembë –dhembë, lulet pesëpjesëshe, në lulesa vile ose mëllth. Hipanti i

sheshte me nje shtrat te gjere dhe zakonisht te myset. Ka nje shtrirje te gjere, frytet e saj perdoren edhe per prodhimin e pijeve alkolike.





b. Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij

Hidrografia e zones

Rajoni Rubik-Rreshen pershkohet nga lumenj dhe perrenj nga te cilet me te medhenj jane Mati dhe Fani.

Lumi Mat buron nga mali I Kaptines dhe eshte I rrembyer. Nga burimi I tij deri ne fshatin Klos ai kalon neper gryka te ngushta, brigje te larta e te thepisura deri ne 90° , por me tej Mati e zgjeron shume shtratin.

Arterie tjeter eshte edhe lumi Zme si dhe disa prroska te vogla , por me prurje te medha vetem ne kohen e reshjeve atmosferike qe kane lidhje direkte edhe me ushqimin e ujerave nentokesore ne kete zone.

Te dhena hidrogjeologjike

Mosha gjeologjike jurasik I siperm qe shtrihet kryesisht ne qytetin e Rubikut dhe me pak ne ate te Rreshenit perfaqesohet nga vullkanite bazike e mesataroacide. Keta shkembinj jane te varfer me ujera nentokesore. Depozitimet e neogjenit dhe te neogjen-kuaternarit jane pershkruar ne nje kompleks ujembajtes sepse perfaqesohen nga depozitime identike ranoro-konglomeratike te cimentuara.

Kuaternari perfaqesohet kryesisht nga depozitime aluviale proluviale. Depozitimet aluviale mbushin luginat e lumenjve kryesor qe pershkojn zonen e rilevuar. Keto depozitime permbajne sasira te konsiderueshme ujerash nentokesore te cilat ushqehen nga infiltrimet e ujerave te lumenjve si dhe nga krahet e luginave te ndertuara prej formacione rrenjesore. Nivelet e ujerave nentokesore ketu luhaten nga 0-4 m nen siperfaqen e tokes dhe varen direct nga nivelet e lumenjve te cilet nga ana e tyre varen nga reshjet.

Depozitimet e neogjenit jane te pershkuara nga shume perrenje te thelle me skarpata shume te pjerreta. Nga ky kompleks dalin burime me debite te rendit 0.01 l/s.

Hidrologjia e Zonës e lumit Fan

Lumi Fan i Madh është degë në vete dhe së bashku me lumin Fan i Vogel përbëjnë lumin Fan ku ky i fundit është dega kryesore e lumit Mat si nga madhesia e siperfaqes ashtu edhe nga shkalla e ujeshmerise. Siperfaqja e pellgut ujëmbledhës të dy lumenjëve Fan i vogël me Fanin e madh është 1076 km².

Fani i vogël me sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 415 km² ka një gjatësi 54.5km dhe lartësi mesatare 734 m. Kjo degë buron nga Maja e Runës në lartësinë 1856m mbi nivelin e detit, dhe mali i Munellës dhe Zebës me lartësi përkatësisht 1991m dhe 1987m mbi nivelin e detit. Përrenjtë kryesor që derdhen në të janë ai i Domgjonit, i Petoçit, i Knellës, i Shankut, i Hebes i Lashtës i Klosit i Bisakut, i Lumthit, i Lëtitnës, i Shëmrisë, i Lgjinit, i Seftës, i Spaçit, i Majës së Madhe dhe i Zmesë që rrjedh në afërsi të Rrëshenit etj.

Fani i madh dhe Fani i vogël bashkohen në afërsi të Rrëshenit tek vendi i quajtur Ura e Fanit duke formuar lumin Fan. Gjatësia e lumit Fan deri në derdhjen e tij ne lumin e Matit, sipër urës së Milotit është 17.5km. Ndërsa gjatësia e lumit Fan i vogël nga fillimi i këtij lumi dhe deri tek bashkimi i tij me lumin Fan i madh është rreth 32km.

Pellgu ujëmbledhës i lumit Fan përfshihet në zonën me klimë mesdhetare kontinentale, e cila karakterizohet në përgjithësi nga një dimër deri diku i ftohtë, dhe një verë e nxehtë. Faktorët klimaterik si reshjet, temperatura e ajrit, avullimi nga sipërfaqja e tokës dhe ujit si dhe deficieti i lagështisë, ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në regjimin hidrologjik të lumit Fan Reshjet atmosferike në formë shiu ose bore janë burimi kryesor i grumbullimit të ujit në pellgun ujëmbledhës të këtij lumi. Bile reshjet e borës në lartësi të mëdha si në malin e Munellës apo të Zebës janë mbi 2 – 3 dhe 4 m dhe mbushin gjithë zgavrat e shpellat karstike të këtyre shkëmbinjëve ku meqë janë gëlqerorë janë dhe ujëdhënës dhe janë furnizuesit kryesor të këtij lumi në kohë pa reshje.

Muajt më me shumë rreshje janë Nëntori(155 – 314mm) dhe Dhjetori(146 – 307mm).

Sasitë më të mëdha të reshjeve rreth 81% e sasisë vjetore bien në periudhën e lagët të vitit (Tetor – Maj) dhe rreth 13 – 14% e kësaj sasive bie në periudhën e thatë.

Në karakterin e lëkundjeve të rrjedhës ujore brenda vitit, rol kryesor luajnë faktorët klimatikë, veçanërisht shpërndarja e reshjeve dhe temperatura e ajrit. Në bazë të shpërndarjes së rrjedhës gjatë vitit mund të thuhet se regjimi i rrjedhës së lumit Fan karakterizohet nga dy faza: Faza më me shumë ujë, ose e lagët e vitit, e cila përfshin periudhën Tetor – Maj dhe faza më me pak ujë, ose e thatë, e cila përfshin periudhën Korrik – Shtator.

Faza e parë karakterizohet nga një shkallë e lartë ujëshmërie për shkak të reshjeve të dendura, ndërsa faza e dytë nga një rënie për arsye të pakësimit të furnizimit nëntokësor. Reshjet në formë shiu që bien gjatë kësaj periudhe ndikojnë pak në rritjen e prurjeve. Përveç kësaj një rol të madh në uljen e rrjedhës kanë dhe humbjet gjatë procesit të filtrimit.

Prurjet më të mëdha në pellgun e lumit Fan formohen kryesisht nga shira të dendura dhe të vazhdueshme të karakterit formal. Në pjesën më të madhe ato formohen në fund të vjeshtës dhe dimrit.

-Rrjedha vjetore.

Për trajtimin e rrjedhjes vjetore të lumit Fan sipas vendmatjes hidrometrike në Fan – Ura e Fanit, ku janë kryer vrojtme të nivelit të ujit dhe matje të prurjeve, u ndërtuan varësitë e prurjeve të ujit në funksion të nivelit. Sipas këtyre varësive u llogariten prurjet ditore, mujore e vjetore për të gjithë periudhën me të dhëna hidrometrike.

Rrjedha ujore e lumit Fan, si dhe e degëve të saj është analizuar nëpërmjet vlerësimit të normës së rrjedhës ujore, ndryshueshmërisë së saj shumëvjeçare si dhe shpërndarjen e kësaj rrjedhjeje brenda vitit.

- Norma e rrjedhës ujore.

Për nxjerrjen e normës së rrjedhjes ujore janë shfrytëzuar të gjitha të dhënat e grumbulluara gjatë periudhës 1948 – 1985, sipas vrojtmeve të plota për tërë këtë periudhë. Norma e rrjedhës ujore për këtë vendmatje është nxjerrë si mesatare aritmetike e prurjeve të të gjithë periudhës disa vjeçare.

Për pellgun e lumit Fan dhe degët e tij është analizuar varësia ndërmjet normës së rrjedhjes ujore (Q_0) dhe sipërfaqes së pellgut ujëmbledhës (F). Kjo varësi shprehet nëpërmjet barazimit: $Q_0 = 0.0069F^{1.27}$

Për lumin Fan vihet re, se moduli i rrjedhjes është i ndyshëm për degët e tij. Kështu për Fanin e madh është më i lartë se ai i Fanit të vogël, dhe pikërisht shtresa vjetore e rrjedhjeve në lumin Fan i madh është 1750, ndërsa në Fanin e vogël(Ndërfan) është 1660mm.

Sheshi ku do të ndertohet vendepozitimi ndodhet mbi molasat miocenike. Ky shesh paraqitet i varfer me ujera nentokesore ne aspektin hidrogeologjike. Duke u bazuar ne kushtet hidrogeologjike kjo zone nuk ndikohet nga rrjedhjet ujore. Largimi i reshjeve ketu eshte i kontrolluar, pasqyra e ujerave nentokesore freatike eshte i varfer me ujera nentokesore.

c. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer

Ndikimet ne biodiversitet

Sipas klasifikimit Palearktik te Habitateve , Shqiperia shtrihet ne dy biorajone: Mesdhetar dhe Alpin. Pjesa me e madhe e Shqiperise i perket tipit Mesdhetar qe perfshin gjithe pjesen jugore dhe ate verilindore te vendit. Ndersa tipi Alpin shtrihet ne pjesen jugperendimore te tij.

Shqiperia eshte nje rruge e rendesishme migrimi per floren dhe faunen. Elementet kryesore te flores shqiptare jane ato mesdhetare 24 %, ballkanike 22 %, europiane 18%, dhe euroaziatike 14 %. Biodiversiteti nënkupton larminë e gjeneve, të llojeve dhe të ekosistemeve në planetin tonë. Biodiversiteti është vlera më e lartë e natyrës, është baza e jetës tonë dhe themeli i zhvillimit të qëndrueshëm. Biodiversiteti natyror nuk ka qenë kurrë më i atakuar se sa në dhjetëvjeçarët e fundit që lidhet me shumë faktorë: shumëfishimi i njerëzimit brenda një kohe të shkurtër, tej-eksplorimi i resurseve, ndotja e madhe etj.

Per ndertimin e vendepozitimit do te behet pastrimi nga shkurret dhe bimesia barishtore qe rritet ne zone por theksojme se nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e percaktuar ne VKM nr. 804 date. 4.12.2003 “ Per miratimin e listes se specieve te flores Shqiptare , qe vihen ne mbrojtje” dhe e listuar ne urdherin e Ministrit nr. 146 date.8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”.


Bimesia qe do te preket nga vendepozitimi perfaqesohet nga mare, shqope, dellinja, frasher, shkoze, gjineshter, ferra, dushku etj.

Ndikimi ne uje

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime negative ne mjedisin ujqor te lumit Fan. Projekti nuk do te kete aktivitet prodhimi qe te perdore ujqin. Pra nuk do te kemi shkarkime ne mjedisin ujqor prites te cilat mund te ndryshojne cilesine e ujerave nentokesor apo siperfaqesore.

Sistemi i administrimit te lengut kullues (leksivateve)

- Nje vaske per grumbullimin e lengut kullues me nje vellim perkatesisht 16m³
- Levizja e lengut kullues drejt vend-depozitimit do te kryhet me vetrrjedhje
- Rrjeti I kanalizimeve qe do te beje transportin e lengut me ane te tubacioneve HDPE me diameter 200 mm
- Tubacionet do te pozicionohen pergjate perimetrit te gropes se vendepozitimit
- Lengu do te riqarkulloje tek mbetjet e ngjeshura me ane te tubacioneve te cara HDPE me diameter 75 mm
- Vaska e mbledhjes se lengut do te pajiset gjithashtu me nje tub betoni i ndertuar nga kanale te parafabrikuar me diameter 800 mm, per mbushjet e teperta i cili do te perfundoje ne te njejten platform, ku do te drejtohen edhe ujerat e reshjeve te shiut.




Administrimi i lengut kullues

Sistemi i administrimit te reshjeve atmosferike

Ky system do te ndertohet nga kanale te parafabrikua prej betony ne forme trapeze te pozicionuar larg buzeve perimetrare te brendshme te gropes ne drejtim te perrenjve te vegjel prane vendepozitimit. Ne kete menyre evitohen qe rrjedhjet siperfaqesore te perfundojne ne gropen e vend depozitimit.

Ai do te sherbeje per te mbledhur ujerat e reshjeve qe rrjedhin ne pjesen e jashtme te pritave gjate periudhes se shfrytezimit te vendepozitimit si dhe ujerat e reshjeve pas mbulimit final te vend depozitimit.



Vend shkarkimi i ujerave

Ndikimet ne toke

Persa i perket ndikimeve ne toke gjate fazes se pregatitjes se sheshit do te kemi ndryshime ne topografine lokale te zones, kjo per shkak te germimeve qe do te behen per sheshin, kanaleve kulluese anesore per sistemimin e ujerave te shiut ne menyre qe te shmanget edhe fenomeni i erozionit. Ndertimi i sheshit te depozitimit nuk prek shkaterrim banesash apo zhvendosje te banoreve te zones, eshte zgjedhur varianti me i mire i mundshem ne menyre qe gjurma e sheshit te depozitimit te mos prek flore te pasur.

Projekti nuk do te perdore lende te cilat mund te shkaktojne kontaminimin e tokes te tipit si emetime kimike apo lende te ngurta te rrezikshme.

Perforcimi i bazamentit ku do te pozicionohet venddepozitimi do te arrihet si rezultat i kombinimit te dy komponenteve kryesore, dheu me rezitence te larte ngjeshje dhe nje shtrese gjeotekstile me rezitence te larte ne terheqje.

Perforcimi gjeotekstil do te vendoset ne toke ne shtresa horizontale duke lejuar nje rezistence ne terheqje me te larte se toka , pa rrjet te perforcuar.

Ndikimet ne ajer

Veprimtaritë kryesore që paraqesin burim të emetimit të pluhurit gjate fazes se ndertimit janë:

- punime shpuese dhe gjermuese,
- punime mbushëse,
- punime shtruese (shtrimi i balastit), dhe
- kryerja e punimeve ndërtuese të tjera.

Gjate fazes se germimit do te kemi ngritje te pluhurave ne ajer por shoqeria ndertuese siguron se do te bej sperkatjen me uje here pas here, sidomos ne kohe te thate dhe me ere. Projekti nuk do te shfrytezoj lende djegese dhe si i tille nuk do emetoje gaze ne atmosfere, me perjashtim te clirimit te gazeve nga makinat e transportit, fadromave si dhe makinerive te tjera por qe jane ne nivele minimale sepse jane te nje teknologjie te fundit si dhe te mirembajtura nga ana teknike ne menyre qe te mos kemi as rrjedhje te karburanteve ne toke. Me perjashtim te rasteve aksidentale ,por qe shoqeria siguron se do te kryej nderhyrje te menjehershme ne raste te tilla.

Natyra e projektit duhet të jetë e tillë që shumica e punimeve realizohen në renditjen e duhur, kështu që shmanget ose pakësohet shkalla e efekteve negative. Gjate fazës operative shkalla e punimeve, niveli i trafikut etj, kanë pak gjasa të jenë mjaft të lartë në atë shkallë sa të shkaktojnë shqetësime në lidhje me zhurmat, ndotjen e ajrit ose lëvizjen e automjeteve dhe këmbësorëve.

Emetimet e gazit nga vendepozitimi

Gjate fazës operative, emetimet vjetore të përbërjeve organike të avullueshme (VOC) nga vendepozitimi nuk do të tejkalojnë 0.1% . Gjithashtu, me përjashtim të CO₂ dhe CH₄, përbërjet e gazeve të emetuara nuk tejkalojnë 0.1%.

Aromat e keqia

Përqendrimi maksimal i ndotësve në periudhën më pak të favorshme të kohës, në periudhën e përdorimit të plotë të vendepozitimit nuk duhet të tejkalojë kufijtë e rekomanduar në vendbanimin më të afërt. Duhet theksuar se CO₂ dhe CH₄ nuk janë substanca që mbajnë erë por konsiderohen si substance indikatore të gazit në vendepozitim. Ndikimi i pakëndshëm i erëra të këqia të vendepozitimit do të pakësohet në largësi me anë të një zone buferizuese të gjelbër përreth vatrës së propozuar dhe nëpërmjet shpërhapjes në ajër. Nivelet e erëra të këqia pritet të jenë të pranueshme gjatë ndërtimit dhe funksionimit të vendepozitimit.

Pavarësisht nga kjo, nëse vendepozitimi funksionon siç duhet, ka pak gjasa që këto nivele të kalohen në vendbanimin më të afërt. Sipas Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe i Monitorimit do të hapet një regjistër i ankesave dhe do të kërkohet një reagim i menjëhershëm i operatorit apo autoritetit menaxhues ndaj ankesave për kundërmimin.


d. Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve

Ndikimet ne uje

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime negative ne mjedisin ujqor te lumit Fan. Projekti nuk do te kete aktivitet prodhimi qe te perdore ujin. Pra nuk do te kemi shkarkime ne mjedisin ujqor prites te cilat mund te ndryshojne cilesine e ujerave nentokesor apo siperfaqesore.

Sistemi i administrimit te lengut kullues (leksivateve)

- Nje vaske per grumbullimin e lengut kullues me nje vellim perkatesisht 16m³
- Levizja e lengut kullues drejt vend-depozitimit do te kryhet me vetrrijdhje
- Rrjeti I kanalizimeve qe do te beje transportin e lengut me ane te tubacioneve HDPE me diameter 200 mm
- Tubacionet do te pozicionohen pergjate perimetrin te gropes se vendepozitimit
- Lengu do te riqarkulloje tek mbetjet e ngjeshura me ane te tubacioneve te cara HDPE me diameter 75 mm
- Vaska e mbledhjes se lengut do te pajiset gjithashtu me nje tub betoni i ndertuar nga kanale te parafabrikuar me diameter 800 mm, per mbushjet e teperta i cili do te perfundoje ne te njejten platform, ku do te drejtohen edhe ujerat e reshjeve te shiut.



Administrimi i lengut kullues

Sistemi I administrimit te reshjeve atmosferike

Ky system do te ndertohet nga kanale te parafabrikua prej betony ne forme trapeze te pozicionuar larg buzeve perimetrale te brendshme te gropes ne drejtim te perrenjve te vegjel

prane vendepozitimit. Ne kete menyre evitohen qe rrjedhjet siperfaqesore te perfundojne ne gropen e vend depozitimit.

Ai do te sherbeje per te mbledhur ujerat e reshjeve qe rrjedhin ne pjesen e jashtme te pritave gjate periudhes se shfrytezimit te vendepozitimit si dhe ujerat e reshjeve pas mbulimit final te vend depozitimit.

Veprimtaritë kryesore që paraqesin burim të emetimit të pluhurit gjate fazes se ndertimit janë:

- punime shpuese dhe gërmuese,
- punime mbushëse,
- punime shtruese (shtrimi i balastit), dhe
- kryerja e punimeve ndërtuese të tjera.

Gjate fazes se germimit do te kemi ngritje te pluhurave ne ajer por shoqeria ndertuese siguron se do te bej sperkatjen me uje here pas here, sidomos ne kohe te thate dhe me ere. Projekti nuk do te shfrytezoj lende djegese dhe si i tille nuk do emetoje gaze ne atmosfere, me perjashtim te clirimit te gazeve nga makinat e transportit, fadromave si dhe makinerive te tjera por qe jane ne nivele minimale sepse jane te nje teknologjie te fundit si dhe te mirembajtura nga ana teknike ne menyre qe te mos kemi as rrjedhje te karburanteve ne toke. Me perjashtim te rasteve aksidentale ,por qe shoqeria siguron se do te kryej nderhyrje te menjehershme ne raste te tilla.

Natyra e projektit duhet të jetë e tillë që shumica e punimeve realizohen në renditjen e duhur, kështu që shmanget ose pakësohet shkalla e efekteve negative.

Gjatë fazës operacionale shkalla e punimeve, niveli i trafikut etj, kanë pak gjasa të jenë mjaft të lartë në atë shkallë sa të shkaktojnë shqetësime në lidhje me zhurmat, ndotjen e ajrit ose lëvizjen e automjeteve dhe këmbësorëve.

Aromat e keqia

Përqendrimi maksimal i ndotësve në periudhën më pak të favorshme të kohës, në periudhën e përdorimit të plotë të vendepozitimit, nuk duhet të tejkalojë kufijtë e rekomanduar në vendbanimin më të afërt.

Duhet theksuar se CO2 dhe CH4 nuk janë substanca që mbajnë erë por konsiderohen si substance indikatorë të gazit në vendepozitim. Ndikimi i pakëndshëm i erëra të këqia të vendepozitimit do të pakësohet në largësi me anë të një zone buferizuese të gjelbër përreth vatrës së propozuar dhe nëpërmjet shpërhapjes në ajër. Nivelet e erëra të këqia pritet të jenë të pranueshme gjatë ndërtimit dhe funksionimit të vendepozitimit.

Zhurmat

Vendepozitimi konsiderohet me prirje për të prodhuar nivele të caktuara zhurme gjatë ndërtimit dhe fazës operative gjatë gjithë ditëve të punës (zakonisht nga e Hëna në të Premte 08:00- 16:00) të shoqëruar me mjete ndërtimi, mjete plehrash dhe kamionë ngjeshësh që vijnë dhe shkarkohen, makineri të mëdha që lëvizin dhe ngjeshin mbetjet e kështu me radhë. Një listë e plotë e pajisjeve në vatër është dhënë më poshtë.

Ndërtimi vendepozitimit do të prodhojë zhurmë dhe dridhje nga:

- Pajisjet e lëvizshme (ekskavator, buldozer, ngjeshës, kamionë plehrash, fadroma, betoniera, ngarkues),
- Pajisje të palëvizshme (përzierës betoni, vinça),
- Trafiku i furnizimit me material dhe lëvizja e tokës së gërmuar në vatrën e propozuar.

Gjatë operacionit në vatrën e vendepozitimit , mjetet dhe pajisjet e rënda do të përfshijnë:

- Mjete që transportojnë mbetje të ngurta
- Një ngjeshës mbetjes i përdorur me ndërprerje për çdo ditë pune,
- Një buldozer i përdorur me ndërprerje për çdo ditë pune,
- Një vinç plehrash e përdorur me ndërprerje për çdo ditë pune.

Nivelet e zhurmës së prodhuar gjatë cikleve të ngarkimit dhe shkarkimit dhe gjatë transportit të mbetjeve, pritët të jenë brenda vlerave të pranueshme të zhurmës së pajisjeve specifike të përdorura. Vlerat e zhurmës së pranueshme të prodhuara nga pajisjet në mjediset e jashtme janë paraqitur në Tabelë

Lloji i pajisjes	Fuqia (kW) - P Masa (kg) - m	Nivel maksimal akustik (dB)
Ngjeshës, dridhës	$P \leq 8$	105
	$8 < P \leq 70$	106
	$P > 70$	$86 + 11 \lg P$
Buldozerë, ekskavatorë, fadroma	$P \leq 55$	103
	$P > 55$	$84 + 11 \lg P$
Buldozerë, ekskavatorë, ngjeshës mbeturinash, kamionë mbetjesh, ngarkues	$P \leq 55$	101
	$P > 55$	$82 + 11 \lg P$
Pirunë ngritës, etj.	$P \leq 15$	93
	$P > 15$	$80 + 11 \lg P$
Vinç plehrash	$m \leq 15$	105
	$15 < m < 30$	$92 + 11 \lg P$
	$m \geq 30$	$94 + 11 \lg P$
Kompresorë	$P \leq 15$	97
	$P > 15$	$95 + 11 \lg P$

Ndikimet ne toke

Persa i perket ndikimeve ne toke gjate fazes se pregatitjes se sheshit do te kemi ndryshime ne topografine lokale te zones, kjo per shkak te germimeve qe do te behen per sheshin, kanaleve kulluese anesore per sistemimin e ujerave te shiut ne menyre qe te shmanget edhe fenomeni i erozionit. Ndertimi i vendepozitimit nuk prek shkaterrim banesash apo zhvendosje te banoreve te zones, eshte zgjedhur varianti me i mire i mundshem ne menyre qe gjurma e sheshit te depozitimit te mos prek flore te pasur.

Projekti nuk do te perdore lende te cilat mund te shkaktojne kontaminimin e tokes te tipit si emetime kimike apo lende te ngurta te rrezikshme.

Perforcimi i bazamentit ku do te pozicionohet vendepozitimi do te arrihet si rezultat i kombinimit te dy komponenteve kryesore, dheu me rezitence te larte ngjeshje dhe nje shtrese gjeotekstile me rezitence te larte ne terheqje.

Perforcimi gjeotekstil do te vendoset ne toke ne shtresa horizontale duke lejuar nje rezistence ne terheqje me te larte se toka , pa rrjet te perforcuar.

Ambalazhi, letrat dhe plastika mbetje qe i merr era perbejne nje shqetesim ne vatrat e vendepozitimeve sepse barten ne distanca nga vatra. Praktika e zakonshme e instalimit te gardheve industrial perreth vatrës së vendepozitimit shkon ne drejtim te zvogelimit te rasisjes së mbeturinave qe merren nga era ne zone perreth, megjithese sasi te medha mbetjesh do te varen ne gardhin rrethues duke e bere te pakendshme pamjen. Sidoqofte, strategjia e parapëlqyer eshte zvogelimi i mbetjeve ambalazh letre dhe kartonit së bashku me iniciativat e riciklimit dhe riperdorimit, si edhe përmirësimit të shfrytëzimit dhe menaxhimit të vatrës së vendepozitimit për të detyruar mbulimin e tij dhe zvogelimin e mbetjeve të letrës dhe plastikës që nuk janë të mbuluara.

e. Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuar

Gjate fazes normale te operimit te projektit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, floren dhe faunen e zones, burimet ujore. Hapja dhe pregatitja e vendepozitimit eshte nje proces i thjeshte ku nuk do te perdoren lende te demshme, nuk do te kete shkarkime te lendeve kimike te demshme per mjedisin ne ajer, toke dhe uje.

Persa i perket emetimeve te plhurave ne ajer ato do te jene prezente vetem gjate fazes se pregatitjes se vendepozitimit. Me perfundimin e pregatitjes se vendepozitimit dhe vendosjes se

shtreses gjeotekstile nuk do te kete me ndikime ne mjedis, mbetjet te cilat do te depozitohen ne vendepozitim do te sistemohen sipas qelizave perkatese , do te ngjishen dhe mbulohen.

Persa I perket aromave te keqia ato do te jene prezente gjate fazes se operimit te vendepozitimit, makinat transportuese te mbetjeve urbane do te jene te mbuluara por ne momentin e shkarkimit dhe ngjeshjes se tyre ne qeliza aromat jane te pashmangshme. Per te shmangur kete ndikim pas ngjeshjes se mbetjeve do te behet edhe mbulimi I tyre kjo jo vetem per te shmangur aromat por edhe per mos lejuar mbetjet e lehta si qese, letra etj ti marr era.

f. Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe velerat e ndikuara qe perfshihen ne te

Duke njohur teknologjine, operacionet ne terren dhe menyren e ndertimit te vendepozitimit u identifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit ne objekt.

Identifikimi i ndikimeve – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i ndertimit te vendepozitimit dhe u identifikuan ndikimet e mundeshme gjate kesaj faze sipas receptoreve te mjedisit.

Vleresimi i ndikimeve – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe perafroon ate me objektivist me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

Shtrirja fizike- Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke nga shfrytezimi eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te ket erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes se marre per studim.

- Kohezgjatja e ndikimit – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem). Ne rastin tone ndertimi i vendepozitimit do te realizohet per nje kohe te shkurter dhe ndikimet ne mjedis do te jene vetem per kete afat kohore, me perfundimin e projektit pasi te plotesohet kapaciteti i projektuar siperfaqja do te rehabilitohet me bimesi te zones.

-Kthyesmeria –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe rigjeneruar) . Me perfundimin e projektit banoret e zones do te kete nje siperfaqe te gjelberuar.

-Rendesia – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, gjurma ku do te ndertohet vendepozitimi ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i ketij aktiviteti. Zhurmat qe krijohen gjate hapjes dhe germimit nuk perbejn ndotje akustike. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz , e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi. Vendepozitimit nuk i lejohet te pranoje mbetje te rrezikshme.

g. Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin

Shpatet e argjinaturave te vendepozitimit do te mbillen me bar dhe do te ngrihet nje zone buferizuese e gjelber perreth vendepozitimit. Mbjellja e bimesisë do te filloje gjate fazës së ndërtimit me qëllim që të jetë gati për fazën operative. Ne perfundim te projektit kur vendepozitimi te mbushet me kapacitetin e projektuar siperfaqja do te mbulohet me dhe, pleherohet si dhe te mbillet me bare dhe peme perreth. Do te krijohet keshtu nje pamje vizuale e kenaqeshme edhe per syrin e njeriut.

Siperfaqe e gjelberuar me peme te zones perreth vendepozitimit $S=7000 \text{ m}^2$

Tabela e shpenzime per rehabilitimin e 1 Ha

AYEN AS ENERGJI

Preventivi i planit te rehabilitimit te pjese se minieres te shfrytezuar me siperfaqe								
Nr	Operacionet	Siperfaqja	Norma	Siperfaqe operacionale	norma m3/ha oper	Volumi I punes m3	Çmimi Leke /m3	Vlera Leke
I	Plani I mbylljes se Karrieres							
Nr	Emertimi							
a	Krehje sistemim ifaqeve anesore	1	1.5	1.5	200	300	50	15000
	Shuma I							15000
II	Plani I menaxhimit te mbetjeve							
a	Sistemimi I mbetjeve te zbulimit	1	0.6	0.6	2000	1200	20	24000
b	Sistemimi I mbetjeve teknologjike	1	0.25	0.25	2000	2000	20	40000
	Shuma II							64000
III	Plani i rehabilitimit perfundimtar te mjedisit							
					nr/ha	nr		
a	Mbushje me dhe e siperfaqes	1	0.5	0.5	2500	1250	35	43750
b	Mbjellje pemesh	1	0.5	0.5	300	150	100	15000
c	Hapje gropash	1	0.5	0.5	300	150	1000	150000
d	Blerje pemesh	1	0.5	0.5	300	150	50	7500
e	Sherbime	1	0.5	0.5	300	150	50	7500
f	Kanali I ujrave te larta		Norma		gjatesi	Volumi	Çmimi leke/ m3	Vlera leke
			ml/ha		ml	m3		
		1	300		300	75	200	15000
g	Sinjalistike							5000
	Shuma (a-g)							243750
	Shuma (I+II+III)							322750
	TOTALI							322750

h. Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve, si te pluhurit ne ajer, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor , faune dhe flore.

Masat ndaj erozionit

Erozioni është një fenomen që rrezikon tokën ose burimin më të rëndësishëm mjedisor. Ai është një fenomen natyror që ka të bëjë me gërryerjen, ç'vendosjen dhe transportin e lëndëve të ngurta

ose materialit tokësor kryesisht nën forcën e veprimit të ujit, akullit ose erës. Aktiviteti human, mund të shkaktoj erozionin e tokës si përsëritje nga ndërtimet apo shpyllezimin e zonave të mbjella.

Disa nga faktorët që influencojnë erozionin janë :

- sasia dhe intensiteti i reshjeve
- kushtet e relievit (përrësia) dhe mënyra e përdorimit të tokës
- degradimi i mbulesës bimore (ç'pyllëzimet, zjarret, mbikullotja etj)
- modifikimi i topografisë (p.sh. ndërtimi i rrugëve, qendrave urbane etj)
- politika e administrimit të ujërave (kanalizimet, veprat hidrike, pritave, etj)

Masat e luftës kundër erozionit synojnë parandalimin e rreziqeve për mjedisin human ose konservimin e burimeve jetësore. Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në afatgjatë ndikon drejtëpërdrejtë cilësinë e jetesës.

Objekti kryesor i luftës kundër erozionit është ulja e shkallës së erozionit në një nivel të pranueshëm për kushtet e mjedisit.

Kjo zone nuk ka predispozim të theksuar për erozion në sipërfaqen e tokës, ky fenomen është në nivele të papërfillshme. Për të shmangur dukurine e erozionit në perimetrin rrethues të vendëpozeve të cilat mund të çojnë në demtimin e strukturës së tij do të hapen kanalet e drenazhimit të ujërave të shiut në mënyrë që të bëhet drejtimi i tyre. Ky sistem do të ndërtohet nga kanale të parafabrikuara prej betoni në formë trapeze të pozicionuar larg buzeve perimetrale të brendshme të gropës në drejtim të perrenjve të vegjël pranë vendëpozeve . Në këtë mënyrë evitohen që rrjedhjet sipërfaqësore të perfundojnë në gropën e vendëpozeve.

Ai do të shërbejë për të mbledhur ujërat e reshjeve që rrjedhin në pjesën e jashtme të pritave gjatë periudhës së shfrytëzimit të vendëpozeve si dhe ujërat e reshjeve pas mbulimit final të vendëpozeve.

Masat për emetimet në ajër

Për mbrojtjen nga gazet e motorëve diesel do të merren këto masa :

Mjetet motorrike do të jenë bashkëkohore që plotësojnë standartet shtetërore. Ato do të jenë të pajisura në marmita me katalizatorë për kapjen e gazeve toksike. Gjithashtu nuk do të ketë ndikim tek punonjësit , floren dhe faunen përreth zonës së gjurmës së vendëpozeve që do të ndërtohet. Për zbutjen e këtyre ndikimeve punonjësit do të pajisen me mjete mbrojtëse nga pluhuri .

Persa i perket pluhurave qe do te krijohen gjate fazes se germimit nga ana e shoqerise lagia e sheshit te punes me uje do te behet me ane te nje autoboti , shpeshhere sidomos ne kohe te thate dhe me ere, kur rreziku i ndotjes se ajrit eshte me i madh.

Minimizimi i sasive të mbetjeve nëpërmjet ripërdorimit të tyre. Dherat qe do te dalin nga procesi i germimit do te perdoren ne fazen e mbulimit te mbetjeve kur hidhen ne qelize.

Persa I perket aromave te keqia ato do te jene prezente gjate fazes se operimit te vendepozitimit makinat transportuese te mbetjeve urbane do te jene te mbuluara por ne momentin e shkarkimit dhe ngjeshjes se tyre ne qeliza aromat jane te pashmangshme. Per te shmangur kete ndikim pas ngjeshjes se mbetjeve do te behet edhe mbulimi I tyre kjo jo vetem per te shmangur aromat por edhe per mos lejuar mbetjet e lehta si qese, letra etj ti marr era. Ne disa raste rekomandohet dhe përdorimi i spray-ve të aromave.

Persa I perket emetimit te gazeve te vendepozitimit kryesisht metan dhe dioksid karboni do te behet Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit të rikuperimit të gazit do të minimizojnë emetimet e kundërmimeve.

Masat per uljen ne minimum te zhurmave

- Makinat e transportit dhe mjetet ngjeshese do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita selenciatore te pakesimit te zhurmave.
- Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat punetoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune “kufje”

Vlerat e zhurmave jane gjithmone poshte normave te lejuara. Jane bere matje te nivelit te zhurmave ne disa objekte te ngjashme ku perdoren te njejtat makineri dhe del se ne distancen 10m nga makinerite zhurmat arrijne nivelin 70 dB.

Shoqeria kontraktuese do te beje futjen e teknologjise se re në ndërtim me nivel të ulët zhurme dhe përdorimi i mjeteve me goma.

Masat per Shkarkimet ne uje

Sic e kemi permendur edhe me siper ky projekt nuk ka aktivitet prodhues. Uji perdoret vetem ne rastin per lagien e territorit per shmangien e pluhurave , por duhet theksuar fakti qe ky uje eshte i paster dhe nuk permban elemente kontaminues per token.

Uji i shiut i cili bie dhe infiltron nëpërmjet masës së mbetjeve do grumbullohet nga sistemet e kullimit dhe mbledhjes në fund të vendepozitimit. Uji i shiut nuk do të depërtojë membranat e nëntëshme të papërshkueshme prej ujit të cilat shtrihen në tërë vatrën e vendepozitimit.

Mbledhja dhe trajtimi i ujit pas mbylljes së vendepozitimit

Pas mbylljes së vendepozitimit uji i shiut i mbledhur nga sistemi kullues i sipërm së bashku me ujin që rrjedh në sipërfaqen nga shpatet e vendepozitimit transportohet në sistemin e zbrazjes. Do të ketë një rezervuar për mbledhjen e ujit të shiut. Uji i mbledhur ka pak gjasa që të ndotet e për këtë arsye nuk do të kërkojë trajtim. Çdo ndikim ujqor mbizotërues do të zvogëlohet me mbylljen përfundimtare të vendepozitimit ekzistues.

Mbajtjen e platformave të pastra nëpërmjet pastrimit të përditshëm duke përdorur një automjet pastrues të pajisur me një pastrues me vakum dhe spërkatës uji.

Mbledhja dhe trajtimi i plotë në sistemin e trajtimit në vatër të ujit të vendepozitimit parandalon ndotjen e ujit nëntokësor.

Mbyllja përfundimtare, formimi I pirgut të dheut dhe rritja e bimëve siguron mosdepërtimin e reshjeve në qelizat e mbyllura të mbetjeve.

Masat per Depozitimet ne toke

Gjate fazes se ndertimit dherat qe do te dalin nga procesi I germimit dhe do te ruhen per mbulimin e qelizave nuk jane te demshme per token sepse kane te njejten perberje mineralogjike me te.

Operacionet e kontrolluara në vatrën e vendepozitimit (kontrolli portës, peshorja e montuar në sipërfaqe, rrethimi), trajnimi i operatorëve të vendepozitimit do të mundësojnë vetëm trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane jo të rrezikshme. Të gjithë mbetjet ngjishen dhe mbuloohen me tokë çdo ditë.

Masat estetike dhe ekologjike

Shpatet e argjinaturave të vendepozitimit do të mbillen me bar dhe do të ngrihet një zonë buferizuese e gjelbër përreth vendepozitimit. Mbjellja e bimësisë do të fillojë gjatë fazës së ndërtimit me qëllim që të jetë gati për fazën operative. Ne perfundim te projektit kur vendepozitimi te mbushet me kapacitetin e projektuar siperfaqja do te mbulohet me dhe, pleherohet si dhe te mbillet me bare dhe peme perreth. Do te krijohet keshtu nje pamje vizuale e kenaqeshme edhe per syrin e njeriut.

Masat per shmnagien e aksidenteve te mundshme

Gjate proceseve te germimit ne fazen e ndertimit por dhe gjate fazes se operimit shoqeria duhet te mbaje parasysh se problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishmet dhe me te mprehta dhe kerkojne vleresim serioz.

Detyrimet e punedhënesit.

Punedhënesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik , duhet te instruktoje dhe tu beje te ditur punemarresve:

- Procesin teknologjik te operacioneve ne teresi dhe te punes ne frontin ku punon.
- Paisjet dhe makinerit qe perdoren

- Shkaqet e aksidenteve dhe masat per menjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, aktet ligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikasteret qe lidhen me to.
- Vecorit e punes ku do punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes per menjanimin e aksidenteve.
- Ndhimen e pare shendetesore.
- Te vendos ne teritorin e vendepozitimit ne vende te dukshme dhe naten te ndricuara tabela qe paralajmerojne punime
- Tu krijoje punonjesve kushte te mira pune
- Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentohet sipas formularit te percaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.

Detyrimet e punemarresit:

- Te njohe mire teknologjine ne perdorim
- Te njoh rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te leshuara nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punes dhe ti zbatoje ato ne pune.
- Te dije mire shkaqet e mundeshme te aksidenteve ne zbatimin e projektit, per cdo proces pune
- Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes
- Kur konstaton shenja te nje avarie te mundeshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare merr masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjith punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik
- Te perdore mjetet e mbrojtjes individuale ne pune, si: rrobat dhe cizme pune, doreza, maskat e mbrojtjes nga pluhuri dhe zhurmat etj
- Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejt.

Masat ndaj zjarrit

Rreziku ndaj zjarrit eshte prezent ne te gjitha mjediset, zjarri eshte nje djegie qe zhvillohet ne menyre te pakontrolluar ne kohe dhe hapesine , pra eshte nje reaksion kimik ndermjet nje trupi te djegshem dhe nje trupi qe djeg. Per te ulur shkallen e rrezikut ndaj zjarrit dhe sigurimin e mbrojtjen e personave nga ana e shoqerise do te merren masat ndaj mbrojtjes se zjarrit. Ne vendepozitim hidrantet do te vendosen ne zona te dukshme ne objektin e zyrave dhe punonjesit do te instruktohen per perdorimin e tyre ne raste aksidentesh.

Masat e zbutjes se ndikimit ne fazen e ndertimit te vendepozitimit

Nr	Lloji i ndikimit	Masat	Komente
1	Shqetesim i shtreses se tokes.	Piketim i sakte i siperfaqes qe do te zer vendepozitimi dhe siperfaqes qe do te vendosen pajisjet dhe do te levizin mjetet.	Ndikimi mbahet brenda kufijeve natyrale te tij
2	Pastrimi i zones se depozitimit te sterileve qe do dalin nga germimi dhe mbajtjes se makinerive. (prerje shkurresh dhe bimesh barishtore)	Shmangie ne maksimum e prerjeve te panevojshme. Kombinim i hapesires duke lene shkurret qe nuk pengojne aktivitetin.	Do te shmangen prerjet e shkurreve dhe do te lihen individe neper zonen e objekteve per te ruajtur gjenomen, teper e vlefshme per fazen e rehabilitimit ne perfundim te projektit.
3	Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit	Levizje dhe parkim i kamioneve brenda zonave te caktuara.	Do te punohet me makineri me goma te gjera qe kane siperfaqe kontakti te madhe per token.
4	Emetim zhurme, gazesh, arome, vibracion dhe pluhuri.	Planifikim paraprak i punes dhe kohezgjatje sa me e ulet e realizimit te operacioneve	Do te ulet koha e zgjatjes se ndikimit.
5	Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes.	Kontroll paraprak i makinerive dhe periodik i vazhdueshem	Mase teresisht eficente si mase pervec rrethanave te vecanta dhe avari te papritura.
6	Gjenerim i mbetjeve te ambalazhe nga aktiviteti i perditshem i punonjesve etj	Do te sigurohen vende te vecanta grumbullimi dhe do te transportohen ne vendgrumbullimin e caktuar	Eficente

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese

Realizimi i objektiveve dhe treguesve të pritsëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjitha treguesve të përcaktuar.

Monitorimi duhet të kryhet nga drejtuesit dhe operatorët e aktivitetit. Monitorimi i vendepozitimit dhe mjedisit pritës, përfshi sipërfaqen dhe ujin nëntokësor, gazin e vendepozitimit do të kryhen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin mjedisor.

Zërat e mëposhtëm do të përfshihen në programin e monitorimit:

- cilesia e ujerave nëntokësore
- cilesia e ujerave sipërfaqësore
- tiparet e lëngjeve që dalin nga vendepozitimi
- parametrat meteorologjike
- leshimet e gazit dhe cilesia e ajrit
- kushtet e vendepozitimit

Monitorimi i ujit nëntokësor

Qëllimi i monitorimit të ujit nëntokësor është të mbrojë burimet e ujit nëntokësor në zonën e Vendepozitimit. Vatrërat e monitorimit të ujit nëntokësor në vendepozitim duhet të konsistojnë minimalisht në dy puse monitorimi. Analiza kimike e plotë e mostrave të tokës dhe përcaktimi i përbërjeve organike të klorinuara do të kryhet nga një laborator i akredituar.

Monitorimi i ujit sipërfaqësor

Monitorimi i ujerave sipërfaqësore do të bëhet në tre pika ku do të merren mostra, me saktësiht: pika 1: lokalizohet para impiantit të trajtimit të lëngjeve dhe rrjetit të kanaleve për të monitoruar ujin e shiut që bie jashtë zonës së vendepozitimit

pika 2 : lokalizohet në rrugën e shkarkimeve të impiantit të trajtimit të ujerave të vendepozitimit

Monitorimi i gazit të vendepozitimit

Monitorimi i gazit të vendepozitimit kërkohet vetëm për të kontrolluar intensitetin e migrimit të gazit nga vendepozitimi në mjedis por veçanërisht kur krahu i punës lokalizohet për të shmangur rrezikun e shpërthimit (metani mund të shpërthejë kur përqendrimi i tij në ajër arrijë 5 - 15 %). Gjate fazës së menaxhimit të vendepozitimit, biogazi do të monitorohet me anë të marrjes së mostrave të biomases. Gjate fazës së pas-mbylljes së vendepozitimit do të nevojitet marrja e mostrave çdo gjysmë viti. Për më tepër, do të bëhet një monitorim i cilesisë së ajrit në dy pika të ndryshme.

Monitorimi i lëngjeve të vendepozitimit

Qëllimi i monitorimit të lëngjeve nga vendepozitimi është të: përcaktojë performancën e sistemit të grumbullimit të lëngjeve, përcaktojë cilësinë e lëngjeve dhe të vlerësojë ngarkesën e lëngjeve gjatë fazave operacionale dhe pas-mbylljes, vlerësojë stabilimin e mbeturinave në masën e vendepozitimit. Mostrat do të mblidhen direkt nga baseni i grumbullimit të lëngjeve.

Matjet meteorologjike

Do të sigurohen një grup parametrash meteorologjike në mënyrë që të përcaktohen karakteristikat meteorologjike të vendndodhjes së vendepozitimit ditë për ditë gjatë fazes operacionale dhe më saktësisht:

- sasia e reshjeve
- temperature (minimumi dhe maksimumi ditor)
- presioni dhe lagështia atmosferike
- rrezatimi total dhe vetëm ai diellor
- drejtimi dhe forca e erës
- avullimi

Vendepozitimi

Matjet e vendepozitimit do të bëhen periodikisht për të verifikuar morfologjinë e vendepozitimit, vëllimi total I mbeturinave dhe kapaciteti i lire i tij.

Monitorimi i mbetjeve

Një sistem regjistrimi të mbetjeve me peshore dhe sistem i kompjuterizuar është i nevojshëm për llogaritjen e pranimit të mbetjeve në vendepozitim. Të gjithë mjetet për trajtimin e mbetjeve që hyjnë në vendepozitim do të regjistrohen në regjistrin e mbetjeve. Të gjithë mjetet që dërgojnë mbetje do të peshohen kur mbërrijnë në vendepozitim dhe kur largohen prej tij.

i. Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime nderkufitare , do te zhvillohet brenda territorit te vendit tone.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Rekomandime.

- o Te behet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike te makinerive
- o Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis
- o Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik
- o Te pastrohen dhe mirembahen kanalet e drenazhimit te ujerave
- o Te kontrollohet kompletimi me tabelat orientuese
- o Mbetjet sterile qe do dalin nga germimi te depozitohen ne sheshin e percaktuar
- o Te respektohen normat e teknikes se sigurimit ne pune nga punetoret.

Perfundime

- Ndertimi i vendepozitimit do ti vij ne ndihme bashkive per grumbullimin dhe depozitim e mbetjeve urbane
- Do te punesohen nje numer i konsiderueshem personash gjate kohes se ndertimit por edhe gjate fazes operimit
- Ky aktivitet nuk perdore lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullsise perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata. Mbetjet qe do te depozitohen jane mbetje urbane jot e rrezikshme
- Ky projekt nuk do shkaktoje ndotje te mjedisit ujq sepse nuk eshte aktivitet prodhimi , uje qe perdoret per eleminimin e pluhurave eshte i paster dhe nuk permban elemente te rrezikshem.
- Ky projekt nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere . Per eleminimin e pluhurave qe krijohen gjate fazes se germimit nga shoqeria ndertuese perdoret sperkatja e shpesht me uje, sidomos ne kohe te thate dhe me ere.
- Niveli i zhurmave qe vijne nga automjetet dhe pajisjet e tjera jane brenda normave te lejuara. Nuk perbejen problem shqetesues per punonjesit dhe as per banoret e zones perreth.
- Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore , pra nuk kemi ndryshime apo demtime te saj duke qene se nuk ekziton ne kete territor. Gjithsesi ne rast se gjate ndertimit zbulohen objekte (zona/relike) qe mund te kene interes arkeologjik, historik apo te trashegimise kulturore, sipas legjislacionit shqiptar, punimet do te nderpriten menjehere dhe te informohet supervizori/autoriteti kompetent.

Pergatiti materialin

STUDIO PROJEKT me autoritet

Ekspert Mjedisi dhe Ing. Miniere

Gjeinxhinier Ermir DERMISHI

Ing. Mjedisi Arvena FEJZULLAI

Ing. Kimiste Anxhela BULLATI

Ing. Pyjesh Gerti BRAHIMI

